



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KUVENDI**

*Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut*

Tiranë, më 22.01.2020  
*Dokument parlamentar*

**RAPORT**

**PËR**

**PROJEKTLIGJIN**

**“PËR RATIFIKIMIN E PROTOKOLLIT TË GJASHTË SHITESË TË  
MARRËVESHJES PËR FORCËN SHUMËKOMBËSHE TË PAQES NË  
EVROPËN JUGLINDORE”**

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në cilësinë e komisionit për dhënie mendimi, në mbledhjen e datës 22.01.2020, mori në shqyrtim projektligjin “Për ratifikimin e protokollit të gjashtë shtesë të marrëveshjes për Forcën Shumëkombëshe të Paqes në Evropën Juglindore”.

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut caktoi relatore për shqyrtimin e këtij projektligji deputeten znj. Ediola Braha.

Në mbledhjen e komisionit, për të mbrojtur projektligjin dhe për të dhënë shpjegime për pyetjet e anëtarëve të komisionit, ishte i pranishëm zëvendësministri i Mbrojtjes, z. Petrit Koçi.

**I. BAZA KUSHTETUESE E PROJEKTLIGJIT**

Projektligji i paraqitur për shqyrtim është propozuar nga Këshilli i Ministrave, sipas përcaktimeve të neneve 78, 83 pika 1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe shoqërohet me relacionin përkatës sipas nenit 68 të Rregullores së Kuvendit.

Ratifikimi i kësaj marrëveshje bazohet në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Kreu II “Marrëveshjet Ndërkombëtare”, neni 121 i saj.

**II. QËLLIMI DHE PËRMBAJTJA E PROJEKTLIGJIT**

Ratifikimi i protokollit të gjashtë shtesë të marrëveshjes për Forcën Shumëkombëshe të Paqes në Evropën Juglindore ka për synim përmirësimin e marrëveshjes bazë, pasi është gjykuar se nevojitet më shumë fleksibilitet në vendimet që merren, për sa i përket mënyrës se si funksionon Forca Shumëkombëshe e Evropës Juglindore (MPFSEE) dhe brigada e

saj SEEBRIG. Nëpërmjet nënshkrimit të këtij protokollit parashikohet një rritje e ndërveprueshmërisë ndërmjet vendeve anëtare të Evropës Juglindore, duke sjellë një rritje të sigurisë rajonale dhe të stabilitetit.

Krijimi i Forcës Paqeruajtëse Shumëkombëshe të Evropës Juglindore (MPFSEE), në nivelin fillestar të një brigade shumëkombëshe (SEEBRIG), u vlerësua si një mundësi e mirë përgatitjeje e personelit të Forcave të Armatosura të secilit shtet, për të qenë të gatshëm për të vepruar më pas, në kuadër të misioneve të NATO-s apo OKB-së.

Vendet nënshkruese të kësaj marrëveshjeje janë 7, konkretisht: Shqipëria, Italia, Turqia, Greqia, Rumania, Bullgaria dhe Maqedonia.

Me kalimin e viteve, modernizimin e kapaciteteve, ndërveprimin në rritje me NATO-n, por edhe vendimeve që janë marrë në kuadër të iniciativës të Ministerialit të Mbrojtjes së Evropës Juglindore, kanë ndodhur shumë ndryshime edhe në mënyrën e funksionimit dhe strukturën e Forcës Paqeruajtëse Shumëkombëshe të Evropës Juglindore. Këto ndryshime janë pasqyruar në marrëveshjen bazë nëpërmjet hartimit dhe nënshkrimit të pesë protokolleve shtesë.

Në kuadër të rritjes së fleksibilitetit të ndërveprimit të SEEBRIG-së me njësitë e tjera në operacione të NATO-s, BE-së dhe OKB-së, si dhe rritjes së efikasitetit të funksionimit bazë të forces, ka lindur nevoja sërish për një amendim të marrëveshjes bazë me një protokoll të gjashtë. Këto ndryshime të marrëveshjes nuk prekin thelbin e saj, pra parimet mbi të cilat funksionon MPFSEE-ja dhe qëllimi për të cilën ajo u krijua.

Projektligji nuk do të ketë asnjë efekt shtesë në buxhetin e shtetit, përveç detyrimeve të ndërmarra që në anëtarësimin fillestar në vitin 2000.

### **III. PËRFUNDIM**

Në përfundim të shqyrtimit të këtij projektligji, Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, pasi vlerësoi se:

**Në aspektin ligjor**, projektligji i propozuar është në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi;

**Në aspektin procedural**, projektligji është paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendit

dhe pasi e shqyrtoi projektligjin në parim, nen për nen dhe në tërësi, e miratoi atë me votat e të gjithë anëtarëve të pranishëm dhe u shpreh dakord për kalimin për votim në seancë plenare.

**RELATORE**

**EDIOLA BRAHA**

**KRYETAR**

**ULSI MANJA**

